



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry



RAPORT VJETOR 2020

Adresa: Rr. "Muharrem Fejza" p.n., Lagjja e Spitalit, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës
Tel: +381 38 200 36 554
Web: www.kipa.rks-gov.net

1. Ndikimi i pandemisë Covid-19 në realizimin e plani të punës për vitin 2020

Agjencia për Pronësi Industriale në planin e punës për vitin 2020 i ka ndarë aktivitetet në këto shtylla: mbrojtja ligjore e objekteve të pronësisë industriale; ngritja e kapaciteteve në fushën e pronësisë industriale; ngritja e vetëdijes së bizneseve dhe qytetarëve mbi rëndësinë e pronësisë industriale; reforma ligjore dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

Për shkakun e masave të vendosura, API nuk ka mundur të realizoj aktivitetet e parashikuara për ngritjen e vetëdijes së bizneseve dhe qytetarëve mbi rëndësinë e pronësisë industriale. Për realizimin e këtyre aktiviteteve janë parashikuar seminare me biznese dhe akterë tjerë të shoqërisë.

Në shtyllat e tjera si ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të API-së dhe reforma ligjore, aktivitetet për këto kanë vazhduar në formën online, ku janë realizuar disa aktivitete trajnuese dhe në bashkëpunim me projektin e EU janë përgatitur draft ligjet në fushën e pronësisë industriale.

Pranimi dhe ekzaminimi i objekteve të pronësisë industriale ka vazhduar sipas rrjedhjes normale, me përjashtim të masave të vendosura, të cilat kanë ndikuar në reduktimin e stafit, rrjedhimisht dhe të shqyrtimit të kërkesave të pranuar.

2. Pranimi i shkresave/aplikimeve


Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin e aplikimeve për objekteve të pronësisë industriale: Marka Tregtare; Patenta; Dizajn Industriale; kundërshtime të markave të publikuara; hulumtime të markave tregtare; patentave; ekzaminime të parakohshme; vazhdime; ndryshime; kërkesa për mbajtje në fuqi; dokumente të përparësisë; ndërrim përfaqësuesi; autorizime gjeneralë; autorizime për lëndë përkatëse; ankesa në komision të ankesave; vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Gjithsejtë gjatë kësaj periudhe kohore, janë pranuar në zyrën e pranimit të dokumentacionit të API-së **7433** shkresa të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Marka Tregtare aplikime	2128
Patenta aplikime	26
Dizajn Industriale aplikime	12
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	1131
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	786
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	2185
Kërkesa për kufizimin e listës së produkteve	10

Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të Markave Tregtare	10
Autorizime	175
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	325
Kundërshtime të Markave Tregtare	68
Kërkesa për zgjatje afati	28
Kërkesa për heqje dorë të Markave Tregtare dhe Patentave	28
Kërkesa për korrigjimin e vendimeve dhe aplikimeve	184
Kërkesa për ekstrakt regjistri	17
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	14
Dokumente prioriteti	119
Kërkesa për informacione të Markave Tregtare dhe Patentave	33
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	35
Ankesa kundër vendimeve të API-së	11
Kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare	29
Vendim i komisionit të ankesave	7
Kërkesa për rivendosje të MT	2
Kërkesa nga pala	53
Kërkesa për revokimin e markës tregtare	4
Vërejtje kundër markës së publikuar	7
Tërhqje kundërshtimi	6

Tabela 1. Statistika e shkresave të pranuar në API, Janar-Dhjetor 2020




3. Ekzaminimi i Aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

Patenta

Numri i aplikimeve të patentave edhe këtë vit nuk është i kënaqshëm, kjo për shkakun e mos anëtarësimit të Kosovës në EPO, dhe industrisë jo të zhvilluar të tregut të Kosovës, pasi aplikuesit e patentave me rastin e aplikimit në shtete të caktuara, shikojnë së pari interesin e shitjes së patentës së tyre, dhe zhvillimin e industrisë së atij vendi. Me rastin e anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave, pritet të rritet numri i aplikimeve për patenta, kjo pasi zvogëlohet kostoja dhe koha e aplikimit, duke krahasuar me mbrojtjen nacionale që aplikohet tashmë në Kosovë.

Ekzaminimi i aplikimeve për patenta kryhet brenda 18 muajve, duke llogaritur nga data e depozitimit të aplikimit për patentë. Pronari i patentës detyrohet të dorëzojë dëshmi me shkrim që shpikja është e patentuar, është e re dhe ka hap shpikës, më së voni pas skadimit të vitit të nëntë të afatit të patentës së dhënë nga Agjencia.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	19
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	15
Vendim për njohjen e patentës	6
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	4
Vendim për refuzimin e aplikacioneve për patentë	13
Hapa në sistemin IPAS	3809
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	319
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	308

Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2020

Marka Tregtare


Numri i aplikimeve për marka tregtare ka shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak për **22.93%**.

API ka vazhduar me shqyrtimin e aplikimeve për marka tregtare, ku përkundër rritjes së numrit të aplikimeve dhe reduktimin e stafit për shkak të masave të vendosura në lidhje me pandeminë, janë përfunduar shqyrtimet e aplikimeve paraprake, dhe po vazhdohet me shqyrtimet e aplikimeve të markave tregtare të pranura gjatë vitit 2020.

Konsiderohet se ka përfunduar back log i aplikimeve të markave tregtare, pasi që kanë përfunduar ekzaminimet e aplikimeve të viteve paraprake , për tu shqyrtuar mbeten vetëm lëndët të cilat kanë pranuar kundërshtime pas publikimit të tyre.

Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesën për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit për regjistrimin e një markë tregtare.

Gjatë për vitin 2020 API ka ndarë një buxhet shtesë për rekrutimin e stafit teknik për përgatitjen e vendimeve, certifikatave, ftesave dhe mirëmbajtjen e skanimit të dokumenteve hyrëse dhe dalëse, pasi stafi profesional është i fokusuar në ekzaminimin e aplikimeve sipas kushteve absolute dhe relative, ndërsa pjesa e stafit e rekrutuar është fokusuar në punët teknike deri në regjistrimin e MT.



Vendime për regjistrimin e markave tregtare	1093
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	1618
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	421
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	28
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare	629
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	902
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	997
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	1535
Ekstrakte regjistri	12
Vendime për refuzimin e MT	62


Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare gjeneruar përmes IPAS

Dizajni Industrial

Si tek aplikimet për patenta ashtu dhe tek aplikimet për dizajn industrial, numri i aplikimeve nuk është i kënaqshëm, kjo për shkakun e zhvillimit industrial që korrespondon me zhvillimin e produkteve të reja në Kosovë. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit. Produkti duhet të ketë karakter individual dhe të jetë i ri në fushën përkatëse.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	15
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial	22
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	49
Vendim për refuzimin e Dizajnit Industrial	17
Ftese për pagesën e regjistrimit të DZ	44
Vendim për ndryshim në regjistër	7

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial



Përmbledhje e tabelave punuese të sektorëve

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2020 kanë kryer gjithsejti **21611** hapa në sistem, hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.

Janë lëshuar **5779** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server, **11622** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të elektronizuar.

4. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklaram të shfuqizimit

Për ti trajtuar kërkesat për kundërshtime dhe kërkesat për shfuqizimin e markave tregtare, Agjencia ka përgatitur Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Agjencinë për Pronësi Industriale. Në këtë Rregullore është parapa formimi i Divizionit Juridik i cili do të merret me shqyrtimin e kërkesave për kundërshtime dhe kërkesat për deklaramin e shfuqizimit të markave tregtare. Rregullorja ka kaluar konsultimet paraprake dhe publike.

Deri më tani janë pranuar **624** kërkesa për kundërshtimin e markave tregtare dhe **45** kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare të regjistruara.

Sipas raportit të përgatitur nga projekti i kaluar i EU, 1 ekzaminues apo ekspert, mund të kryej deri në 66 kundërshtime në bazë vjetore (raporti Mr. Hallgren datë 01/11/2014).

5. Publikimi i Buletinit të API

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **10** Buletine të Pronësisë Industriale me **4963** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, vazhdimet e markave tregtare, regjistrimet e patentave dhe dizajnit industrial.

Duke u mbështetur në buletin pronarët e markave të mëhershme të cekur në nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 04/L-026 mund të paraqesin kundërshtimet e tyre. Këto kundërshtime duhet të dorëzohen mbrenda periudhës kur Buletini Zyrtar është i hapur apo brenda 3 muajve nga data e publikimit të Buletinit Zyrtar.

Përveç Buletinit, Agjencia në web faqen e saj publikon dhe regjistron online ku publiku mund të kërkojë për objekte të pronësisë industriale. Këto shërbime e bëjnë API institucion transparent dhe në linjë me zyrat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>



6. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Ka vazhduar përditësimi i regjistrit online për marka tregtare. Ky regjistër përditësohet çdo ditë kalendarike.

The screenshot shows the IPAS web interface with the following details:

- Page Title: SISTEMI I KËRKIMIT TË AGJENCISË PËR PRONËSI INDUSTRIALE
- Sub-headers: PATENTA, DIZAJN INDUSTRIALË DHE MARKAT TREGTARE TË DEPOZITUARA NË KOSOVË
- Search Filters: Flamuri (Flag) set to Kosova, Shteti (Country) set to Kosova, Patenta (Patents) set to 0, Dizajn (Designs) set to 0, Marka Tregtare (Trademarks) set to 31,506.
- Map: A world map with a blue bar indicating the search scope, ranging from 31,006 to 31,006.
- Footer: WIPO logo, search options (KËRKO, EKSPORTO), and version information (1.3.2).

Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2020 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **21** lajme dhe publikuar në web faqen www.kipa.rks-gov.net.

7. Seminare & Aktivitete

Janar

Dhjetëra studentë të nivelit master të Fakultetit Juridik në UBT, të specializimit e Drejta Biznesore Evropiane dhe Ndërkombëtare, në shoqërimin e profesorit Altin Maliqi, kanë vizituar Agjencinë për Pronësi Industriale, me ç'rast janë njoftuar nga afër me procedurat e regjistrimit të markave tregtare në Kosovë.

Studentët janë pritur nga drejtori i përgjithshëm i kësaj agjencie, Nezir Gashi, ku i njoftoi ata për të drejtat, obligimet dhe procedurat e regjistrimit të markave tregtare.



Drejtori i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Gashi, zhvilloi një takim me udhëheqësen e projektit të EU, Zj. Arife Yilmaz. Projekti “EU Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, është një projekt i financuar nga Bashkimi Europian në mbështetje të institucioneve të pronësisë intelektuale në Kosovës. Qëllimi i projektit është forcimi i kapaciteteve administrative, përafrimi i infrastrukturës ligjore me atë të BE dhe zhvillimi i aktiviteteve vetëdijësuese mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale.

Në këtë takim u diskutua mbi planin vjetor të Agjencisë, të arriturat dhe sfidat që e presin Agjencinë në vitin 2020. Po ashtu, udhëheqësja e projektit prezantoi planin e projektit në pika të shkurta dhe u dakordua për forcimin e bashkëpunimit për organizimin e aktiviteteve.



Agjencia për Pronësi Industriale organizoi takimin vjetor me Përfaqësuesit e Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale. Në takim u diskutua raporti vjetor i Agjencisë, të arritura dhe sfidat në fushën e pronësisë industriale dhe u mirëpritën sugjerimet dhe rekomandimet e palëve të interesit për përmirësimin e shërbimeve të Agjencisë.



Shkurt

Agjencia për Pronësi Industriale mbajti takim informues me ekspertin e angazhuar nga projekti i EU, Z. Baris Cihan Baser. Z. Baris, do të punoj në përgatitjen e Strategjisë për Promovimin e Pronësisë Industriale, e cila do të sjell praktikatat më të mira nga vendet e rajonit dhe ato europiane. Përmes kësaj strategjie synohet rritja e ndërgjegjësimit së grupeve të interesit mbi pronësi industriale.



Mars

Më 12 Mars është mbajtur takimi i parë për këtë vit i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale. Takimi u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Gashi. Në takim morën pjesë dhe përfaqësuesit e Zyrës për të Drejtat Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përfaqësuesi nga Dogana e Kosovës, Inspektorati i Tregut, Gjykata dhe përfaqësuesi i projektit të EU - IPA 2017. Në takim u diskutua mbi raportin e punës së Këshillit Shtetëror dhe planin e punës për vitin 2020, me theks forcimin e koordinimit ndërinstytucional të njësive që merren me pronësinë intelektuale në Kosovë.

Këshilli e ka të obliguar të përgatitë një raport me rekomandime në baza vjetore për Qeverinë e Republikës së Kosovës, raporti përfundimtar i punës për vitin 2019 është dorëzuar në fillim të këtij viti kalendarik.



U shënuar Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale përmes aktiviteteve online, për shkak të masave shtrënguese nga pandemia Covid-19.



**INOVONI
PËR NJË TË
ARDHME
TË GJELBËR**

**DITA BOTËRORE
E PRONËSISË
INTELEKTUALE
2020
26 PRILL**
#worldipday



Qershor


Agjencia për Pronësi Industriale me ndihmën e projektit të EU “Support for Intellectual Property Rights System in Kosovo” po punon në nismat e reja mbi plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve ekzistuese që rregullojnë fushën e pronësisë industriale. Në vazhden e këtyre nismave, Drejtori i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Gashi u takua me ekspertën e projektit të EU Znj. Plakolli.

Në takim u diskutua mbi draft ndryshimet e ligjeve të cilat janë përgatitur nga projekti në koordinim me API-së dhe u darkordua që propozim ndryshimet të diskutohen nga grupeve punuese të formuara nga palët e interesit.



Shtator

Është mbajtur takimi i 2 i Komitetit Drejtues të Projektit të EU “Mbështetje për sistemin e Pronësisë Intelektuale në Kosovë”. Gjatë takimit u diskutua mbi realizmin e planit të projektit në periudhën e parë të këtij viti. Projekti e mbështet pronësinë industriale në 3 pika: reforma legjislative, forcimi i kapaciteteve humane dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi pronësinë industriale.



Me ndihmën e projektit LuxDev është mbajtur trajnimi për zyrtarët e Agjencisë për Pronësi Industriale për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale sipas Udhëzuesit të EUIPO (Zyra Europiane për Pronësi Intelektuale). Qëllimi i programit të trajnimit ishte sigurimi i praktikave të qëndrueshme të EU gjatë ekzaminimit të markave tregtare dhe dizajnëve industriale.

Po ashtu u mbajtë dhe trajnimi mbi Direktivën e Sekreteve Tregtare. trajnimi i organizuar pati qëllim kuptimin e obligimeve që dalin nga Direktiva dhe trajtoi shembuj praktik nga transpozimi i Direktivës në legjislacionin nacional të vendeve të EU dhe Rajonit.



Tetor

Një delegacion i kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Znj. Ledina Beqiraj, qëndroi për vizitë në Agjencinë për Pronësi Industriale. Gjatë takimit u diskutuan mënyrat e bashkëpunimit të zyreve homologe në fushën e pronësisë industriale, bashkëpunim ky i formalizuar me marrëveshjen e bashkëpunimit, arritur gjatë vitit 2018.

Me këtë rast, Nezir Gashi, Drejtor i Agjencisë për Pronësi Industriale të Kosovës, e cilësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Shqipërisë. Ai theksoi se shkëmbimi i përvojave në mes këtyre dy institucioneve është ndihmesë e madhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj fushe në të dyja vendet.

Ndërsa, Drejtoresha e Përgjithshme për Pronësi Industriale e Shqipërisë, Ledina Beqiraj Agalliu u zotua se do të vazhdojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin me Agjencinë për Pronësi Industriale. Ajo theksoi se organizimi i trajnimeve për stafin, aktivitetet promovuese, shkëmbimi i përvojave ndërmjet dy institucioneve do të jenë vetëm disa nga veprimet mbështetëse për avancimin e Kosovës në fushën e pronësisë industriale.




Nëntor

Drejtori i Agjencisë mori pjesë në takim në mes të Ministrit, Vesel Krasniqi dhe ambasadores së Francës në Prishtinë, Marie-Christine Butel, ku njëra ndër temat ishte dhe trajtimi i aplikacioneve për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimeve të Origjinës, me theks të veçantë aplikimi për Djathin e Sharrit dhe atë për Cognac-un.



Dhjetor

Është mbajtur trajnimi online për procedurat e regjistrimit të markave tregtare, me theks shqyrtimin e kërkesave për kundërshtimin e markave tregtare, baza relative për refuzimin e markave tregtare. Ky trajnim është mundësuar nga projekti EU-IPR me trajnuesit nga Italia Z.Giulio Cesar Gzanetti dhe Mauro Delluniversita



Me mbështetjen e projektit të EU “Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, është krijuar llogoja e re e Agjencisë. Llogoja do të shërbej si identitet i Agjencisë për Pronësi Industriale në komunikime me palët duke përfshirë të gjitha dokumentet zyrtare të cilat lëshohen nga Agjencia.



Aktivitetet tjera:

Pjesëmarrja në sesionin informues për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, e organizuar nga Zyra për Komunikim Publik e Zyrës së Kryeministrit në bashkërendim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe në mbështetje të Projektit për mbështetjen e zhvillimit të politikave nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Agjencia për Pronësi Industriale realizoi një takim me ekspertin Mr. Dimiter Gantchev, i angazhuar nga projekti i EU IPA 2017. Mr. Gantchev do të punoj në studimin mbi ndikimin e pronësisë industriale në ekonomike kosovare. Ky takim ishte takimi i parë njoftues, ku API u njoftuar me kërkesat e ekspertit për të dhënat të cilat i posedon Agjencia mbi objektet e pronësisë industriale

Agjencia ka vazhduar raportimet vjetore për realizimin e planit vjetor për zbatimin e MSA dhe inputet vjetore për raportin e progresit. Agjencia në fund të vitit kalendarik përgatitë planin e MSA dhe Planin Vjetor të Qeverisë, dhe raporton për realizimin e tyre në baza 3 mujore.

Janë lëshuar 4 certifikata për regjistrimin e përfaqësuesve të ri në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar.

Në vazhdën e bashkëpunimit në mes të Doganës dhe Agjencisë, është realizuar një prezantim online i sistemit IPAS. Qëllimi i prezantimit ishte gjetja e mënyrë për lidhjen e sistemit të IPAS me sistemin e Doganave për aplikimin për veprim Doganor. Pronari aplikon për veprim Doganor, dhe me numër regjistrimi të API-së mund të tërhiqen të dhënat bibliografike të cilat janë publike dhe në regjistrin online.


Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimet e Task Forcës Kundër Piraterisë dhe Falsifikimit.

Pjesëmarrje në takim online me Institutin e Prishtinës për studime politike, Tema: Reforma e racionalizimit të Agjencive Ekzekutive dhe Rregullative.

Është përgatitur Koncept Dokumenti për ndryshimin e ligjeve në fushën e pronësisë industriale. Ligjet të cilat pritet të ndryshohen janë: Ligji për Patenta, Ligji për Marka Tregtare, Ligji për Dizajnin Industrial dhe Ligji për Topografitë e Qarqeve të Integrumë. Si nismë e re ligjore do të jetë Ligji mbi Sekretin Tregtar, për zbatimin e Direktivës së BE nr. Direktiva (BE) 2016/943.

8. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **377,305.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar **6985** fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.



9. Raportet ndërkombëtare mbi pronësinë industriale

Raporti i Progresit – KE 2020

Raporti i progresit i KE për vitin 2020, vlerëson API-në në punën e saj. Raporti thotë se API ka bërë progres të mirë në reduktimin e back log, shtimin e kapaciteteve administrative, përditësimin e sistemit të saj IPAS dhe ka ngritur sistemin për ekzaminimin e aplikacioneve të treguesve gjeografikë.

Rekomandimet e raportit janë: forcimi i kapaciteteve administrative-buxhetore, reforma ligjore dhe organizimi i aktiviteteve të promovimit.

Raporti DASH 2020

Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan, publikuar për vitin 2020 ka folur dhe për Pronësinë Intelektuale, pjesë e së cilës është prona industriale. Raporti thekson se Kosova ofron mbrojtje të fortë ligjore për pronën industriale përmes ligjeve të cilat janë në përputhje me konventat ndërkombëtare, edhe pse Kosova nuk është pjesë e këtyre konventave.

Raporti vlerëson procedurën e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale në Kosovë, ku thekson se “regjistrimi i objekteve të pronës industriale bëhet konform praktikave regionale dhe ndërkombëtare”. Regjistrimi i markës tregtare mund afërsisht 9 muaj kohë dhe i patentave afër 18 muaj. Afati 18 muaj është afat i vendosur për mbrojtje të shpikjeve nga publikimi i hershëm, që do të dërgonte në humbjen e rrisë së shpikjes.

10. Sfidat

Agjencia për Pronësi Industriale siç është cekur vazhdimisht në raportet e EU dhe mekanizmave të tjerë, vuan nga mungesa e resurseve humane dhe vepron me një buxhet të limituar për kryerjen e shërbimeve sipas mandatit të saj ligjor.

Për ti adresuar të gjeturat e raportit të progresit dhe rekomandimeve, Agjencia ka përgatitur Strukturën e re Organizative e cila parashikon një staf prej 21 zyrtarëve. Struktura e re Organizative përmban themelimin e Divizioni Juridik dhe Divizionit për Promovimin e Pronësisë Industriale. Miratimi i Strukturës Organizative të API-së, do të krijonte kushte për shqyrtimin me kohë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tek palët.

11. Donatorët

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. IPA 2017 Project “ EU Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, projekti 3 vjeçar i filluar në Tetor 2019, përfundon më 18 Tetor 2022.
2. Technical Assistance by Luxembourg-Development – projekti mbështet disa aktivitete në forcimin e kapaciteteve.